



Dokumenti i
Forumit për Trashëgiminë Kulturore
lidhur me
Ligjin për Qendrën Historike të qytetit të Prizrenit

Të nderuar,

Dokumenti në vazhdim është i hartuar në dy pjesë. Në pjesën e parë është i dhënë qëndrimi i forumit për implikimet politike në zbatim të ligjit, gjersa në pjesën e dytë janë dhënë rekomandimet, gjegjësisht propozimet për ndërmarrësitë lidhur me zhvillimin e qytetit të Prizrenit të cilat janë në funksion të zhvillimit ekonomik lokal.

1. Implikimet politike të zbatimit të ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Forum i pajtohet që të përfshihen të gjithë përfaqësuesit e religjioneve, por nuk pajtohet me rolin vendim-marrës të tyre. Forumi pajtohet që palët religjioze të përfshihen në trupa këshillë-dhënëse. Mekanizmi i vendim-marrjes përmes shumicës së cilësuar do të shmangë qfarëdo pakënaqësie në komunitetin e biznesit, të banorëve të zonës së parë historike, të shoqërisë civile dhe të popullatës në përgjithësi.

2. Propozimet/rekomandimet e forumit

Hyrje:

Turizmi kulturor si pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore është segmenti më të shpejtë në tregun e turizmit. Sipas një statistike të Organizatës Botërore të Turizmit, turizmi kulturor shënon rritje vjetore në nivelin 15%, ndërsa 37% i të gjitha udhëtimeve ndërkombëtare përmbajnë në vete një komponentë kulturore. Është përgjithësisht e njohur që turistët kulturorë shpenzojnë shumë më tepër se sa turistët standardë. Gati në të gjitha udhëtimet dhe lëvizjet turistike në botë, pa marrë parasysh qëllimin, kohë e veçantë i ndahet vizitës nëpër objekte të kulturës dhe njohjes me pasuritë kulturore të vendit të destinimit. Kjo dinamikë gjithnjë në rritje e turizmit kulturor bën që studiues të ndryshëm të këtij sektori zhvillimor të ekonomisë të konstatojnë se në fakt nuk ka lloje të tjera të turizmit, por ekziston vetëm një, turizmi kulturor. Turizmi kulturor gjeneron përfitime ekonomike për ekonomitë lokale sepse vizitorët shpenzojnë të holla për hyrje (nëpër objekte), ushqim dhe pije, transport, karburante, akomodim e shumë të tjera. Këto shpenzime direkte paraqesin mjete (të holla) të reja për ekonominë lokale dhe stimulojnë krijimin e vendeve të reja të punës dhe të rritjes së të ardhurave për faktin se këto të holla qarkullojnë nëpër ekonominë lokale. Qyteti i Prizrenit duhet të shfrytëzojë të gjitha mekanizmat përmes Ligjit për Qendrën Historike ashtu që trashëgimia kulturore përmes turizmit kulturor të jetë në funksion të zhvillimit lokal dhe atij të përgjithshëm.

Zhvillimi i qendrës historike të qytetit

Në mënyrë që trashëgimia kulturore të jetë në funksion të zhvillimit lokal dhe të përgjithshëm, Forumi për Trashëgiminë Kulturore jep propozim/rekomandim që çështjet vijuese të përfshihen në Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

a) Të krijohet linja buxhetore për destinim mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qendrës historike përmes vendosjes së "taksës së qytetit"

Mënyra dhe arsyetimi: Taksa komunale e qytetit vendoset për: a) subjektet afariste shërbyese hoteliere (kafeteritë, restorantet, qebaptoret, motelet, hotelet etj) të cilat ushtrojnë veprimtarinë edhe jashtë objekteve fizike. Lartësia e taksës prej 5 % do të ishte e mjaftueshme dhe e pranueshme nga bizneset. Taksat e tilla do të mblidheshin në kuadër të një linje të re buxhetore me kod të ri ekonomik, fondet e së cilës do të përdoreheshin për mirëmbajtje dhe zhvillim të qendrës (ndërgjegjësim, promovim, rehabilitim të infrastrukturës etj). Fondet do të menaxhoheshin nga "Zyra për zhvillim të turizmit", organ i krijuar nga zyrtarë gjegjës të komunës, të MKRS, të organizatave të shoqërisë civile, të komunitetit të biznesit dhe të entit për mbrojtjen e monumenteve; dhe b) nga taksat komunale për dhënie të lejes së ndërtimit/renovimit/rehabilitimit të objekteve që gjenden në zonën e parë të mbrojtur të ndahen 20 % në kuadër të linjës buxhetore të krijuar sikur u cek më lartë.

Të gjitha mjetet e grumbulluara në atë linjë buxhetore nuk destinohen për hapësirat jashtë zonës së parë, gjegjësisht qendrës historike të qytetit.

b) Stimulimi i bizneseve lokale

Mënyra dhe arsyetimi: Ato biznese, të cilat merren me shërbime që promovojnë turizmin kulturor dhe që gjenden me lokacion në qendrën historike (psh shitoret e suvenireve, zanateve e të ngjashme) të lirohen 50 % nga taksat komunale. Kjo me kohë do të mundësojë hapjen e më tepër bizneseve të këtilla, që do të thotë më tepër turistë. Po ashtu komuna identifikon hapësirat në pronësi të saj që gjenden në qendrën historike dhe i lëshon me qira në lartësi prej gjysmës së shumës së planifikuar për subjektet afariste që zhvillojnë dhe promovojnë trashëgiminë kulturore dhe turizmin kulturor.

c) Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore

Mënyra dhe arsyetimi: Zyrtarë të MASHT-it përgjegjës për kurrikulën dhe stafi profesional i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA-së) përmes aktiveve profesionale gjegjëse hartojnë modulën e mësimdhënies për Trashëgiminë Kulturore dhe Turizmin Kulturor. Bazuar në Ligjin për Arsim në Komuna dhe Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, DKA merr vendim që si lëndë zgjedhore "Turizmi Kulturor" të përfshihet në 5 shkollat e mesme të komunës përfshirë paralelet e ndara në shtatë objektet rurale. Lënda zgjedhore realizohet për klasat e 12-ta dhe 13-ta. Kurrikula e kësaj lënde do të përmbante objektivat mësimore si kuptimi i trashëgimisë kulturore dhe i turizmit kulturor, promovimi i tij, shkathtësia e ciceronëve etj. Përmes kësaj komuna do të krijonte parakushtet për rritje të turizmit kulturor dhe do të ofronte mundësi që një pjesë e rinisë e shkathtësuar për ciceronë të inkuadrohet në tregun e punës. Në fund të çdo viti shkollor komuna e Prizrenit do të kualifikojë të paktën prej 100-120 të rinj të shkathtësuar për ciceronë. Vetëm 15 % të tyre do të kenë gjasa të inkuadrohen, me çka komuna për çdo vit përfiton rreth 15 ciceronë relativisht të gatshëm për treg të punës. Në shtigje të gjata kjo sjell rritje të turizmit.

ç) Themelimi i Zyrës për Zhvillim të Turizmit Kulturor

Mënyra dhe arsyetimi: Ligji duhet të ofrojë mundësinë e hapjes së zyrës për zhvillim të turizmit por jo nën menaxhimin e tërësishëm të komunës. Ligji duhet të theksojë krijimin e një organi qeverisës i përbërë prej komunitetit të biznesit, komunitetit artistik, shoqërisë civile, komunës, entit për mbrojtjen e monumenteve, MKRS-së, Ministrisë të mjedisit e planifikimit hapësinor. Si organ do të ketë a) funksionin e promovimit të Prizrenit në gjithë Kosovën (inventarizimin e shërbimeve komerciale dhe publike që lidhen me turizmin, rolin ndërlidhës mes ofruesve të shërbimeve dhe kërkesës, ndërgjegjësimin e vazhdueshëm përmes materialeve promovuese, ofertave për turizëm, ofrimit të ciceronëve, menaxhimit të fondeve të taksës së qytetit, angazhimin e vullnetarëve për mirëmbajtje etj) dhe b) promovimit ndërkombëtar të qytetit të Prizrenit dhe ndërlidhjen mes ofertave dhe kërkesave (përmes krijimit të web-faqes duke theksuar atraksionet e qytetit, binjakëzimit me qytete tjera simotra, krijimit të lidhjeve me qytete të tjera dhe me institucione kulturore evropiane etj). Vendimet për destinimit e mjeteve të mbledhura do të merren me koncesion.

Prizren, më 3 shkurt 2010